



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1167 Prot.

Tiranë, më 25. 10. 2023

**V E N D I M**

**Nr. 213, Datë 25.10. 2023**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>2</sup>, mori në shqyrtim ankesën nr. 215, datë 16.10.2023, të paraqitur nga znj. I.K, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesja I.K parashtron:

*“Departamenti i KMDP<sup>3</sup>, Fakulteti i Muzikës në Universitetin e Arteve, me shkresën datë 09.10.2023, nr.856 “Mbi shpalljen e kriterëve, tarifave dhe kuotave në ciklin e tretë, doktoratë në Muzikologji”, të Shefit të Departamentit të KMPD drejtuar Dekanit shpall kriteret, kuotat dhe udhëheqësit e doktoraturave në Muzikologji. Në listën e udhëheqësve të doktoraturave janë përfshirë pedagogë të dy departamenteve të KMPD dhe Interpretim, të kategorisë Profesor dhe Profesor i asociuar (10 profesorë dhe 9 profesorë të asociuar). Duke qenë pjesë e Departamentit të Interpretimit dhe me titullin Profesor i asociuar, jam përjashtuar nga kjo e drejtë.*

*Tema të cilës i referohen doktoraturat është muzika shqiptare (Muzika nga 1990-2023 dhe Muzika në shoqërinë shqiptare). Kjo listë është shpallur papritmas, pra procedurat janë të panjohura dhe variantet shpjeguese janë të ndryshme. Fakti që nga viti 2011 kam fituar titullin Profesor i asociuar dhe kontributet në muzikën shqiptare janë evidente më bën të bëj këtë ankesë. Pra, përjashtohem jo vetëm si Professore e asociuar, në violinë jam e vetmja Professore e asociuar në Katedrën e Violinës, por nuk vlerësohen dhe arritjet në muzikën shqiptare, ku jam*

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>3</sup> Departamenti Kompozicion –Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji

*krijuese dhe interpretuese me vepra për violinë, të cilat janë vlerësuar me çmime në tri konkurse të rëndësishme ndërkombëtare, në Slloveni, Vjenë dhe Maltë. Ky përjashtim më penalizon në marrjen e titullit Profesor, pasi Profeshori i Asociuar duhet të udhëheqë doktoratura për të përmbushur kriteret për marrjen e titullit profesor. I jam drejtuar Shefit të Departamentit KMPD me shkresën e datës 11.10.2023, për dijeni Dekanit dhe Rektorit të Universitetit të Arteve.*

*Mospërfshirjen në drejtimin e doktoraturave e shikoj si shkelje të barazisë, si vazhdim i padrejtësive të cilat me shkresa janë të dokumentuara në protokollet e FM, UA, madje ka dhe vendime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky qëndrim është arrogant, fyes, në momentin kur vetëm 2 javë më parë nderohem me dy çmime ndërkombëtare, në dy konkurse të rëndësishme si “Amadeus Composition Competition Vienna, për krijimin dhe interpretimin e “Koncertit për violinë në la minor, ardhur pas 30 vitesh mungesë në muzikën violinistike shqiptare. Vlerësuar nga një juri profesorësh të shquar të universitetit të Vjenës, me profesorë nga Gjermania, Amerika, krahas konkuresve, emra me zë të botës së kompozicionit. Çmimi i tretë është një sukses shqiptar. Me “7 Capriccio për violinë solo” nderohem me çmimin e parë në “Malta Composition Competition”, një konkurs 10 vjeçar, ku përfshihen emrat e muzikantëve e kompozitorëve nga gjithë bota. Për herë të parë Shqipëria është fituese.*

*Një vit më parë nderohem në Slloveni me çmimin e dytë dhe Golden Award në kategorinë profesor në konkursin “Oscar Rieding”. E vetmja krijuese dhe interpretuese në violinë në Shqipëri, organizoj 11 edicione të Maratonës Violinistike “Violinistic Greetings” ku të huaj violinistë të niveleve tejet të larta interpretojnë pjesë shqiptare. Capricci n1 bëhet pjesë e programit të studentëve të violinistës së famshme Ida Bieler në Universitetin e Nord Caroline, USA, interpretohet dhe në Mynih. Të tjera pjesë interpretohen nga violinistë të niveleve të larta në Brazil, Serbi, Slloveni, Austri.*

*Edicionet e Maratonës Violinistike kanë qenë tribunë e muzikës së vjetër shqiptare, me premierat e Sonatës së Nolit, nokturnit të Kostandin Papajorgjit, pjesët e Thoma Nasit, të cilat gjenden të interpretuara e regjistruara live për studiuesit shqiptaro-amerikanë në Bibliotekën Noliane në Boston. Koncertet për muzikën violinistike kanë përfshirë krijimtarinë e Lec Kurtit, gjetjen e afishes së recitalit të parë për violinë të 1926, deri në krijime të reja të miat si Balladat, Fantazi, 8 Capriccio, Koncert për Violinë, Duo për Violinë e cello, Romanze për soprano etj. Interpretuese, krijuese dhe organizatore e aktiviteteve shqip për violinë, jam e vetmja pedagoge e departamentit të interpretimit me më shumë se 200 artikuj të botuar e 5 libra. “31 Capriccio Artistike” përfshin një numër të madh krijimesh për muzikën shqiptare, botuar në prestigjiozet Exlibris si dhe shtypin e përditshëm. Ky aktivitet si kompozitore, interpretuese, publiciste, vlerësimi në konkurset prestigjioze jashtë, aktivitet ku promovohet muzika shqiptare janë arsyeja e diskriminimit. “Overqualified”.”*

*Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri, anulimin e listës së publikuar brenda datës 3 nëntor që është dhe data e përfundimit të dorëzimit të dokumentave nga aplikantët për doktoratura. Siç ka procedura për aplikantët kërkoj të ketë dhe për udhëheqësit, kontributet e tyre me muzikën shqiptare.*

## II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës.

Bazuar në aktet e vendosura në dispozicion nga ankuesja, rezulton se, ankuesja është e datëlindjes 25.12.1969, lindur dhe banuese në Tiranë. Znj. K. është pedagoge në Departamentin e Interpretimit, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve. Me vendimin nr.54, datë 06.07.2011, të Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Muzikës, në Universitetin e Arteve, znj. I.K ka fituar titullin “Profesor i Asociuar”.

Me shkresën e datës 06.10.2023, Departamenti KMDP, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, i ka përcjellë Dekanit të Fakultetit të Muzikës, kriteret, tarifat dhe kuotat për ciklin e III-të, Doktoratë në “Muzikologji”, për vitin akademik 2023-2024. Me shkresën nr.856 prot datë 09.10.2023, Dekani i Fakultetit të Muzikës, e ka përcjellë shkresën e Departamentit KMDP tek Zv.Rektori i Universitetit të Arteve.

Pasi është njohur me shpalljen e mësipërme, ankuesja deklaron se në datën 11.10.2023, i është drejtuar Departamentit të KMPD dhe për dijeni Dekanit të Fakultetit të Muzikës dhe Rektoratit të Universitetit të Arteve, duke kërkuar ndër të tjera, anulimin e listës së publikur me emrat e pedagogëve udhëheqës, ndalimin e selektimeve pa kriter, përfshirjen e procedurave normale larg miqësive dhe inateve.

Ankuesja i është drejtuar Komisionerit me ankesën nr.215 regj datë 16.10.2023, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore, pasi nuk është përfshirë në listën e miratuar të udhëheqësve shkencorë për ciklin III, doktorantë në “Muzikologji” për vitin akademik 2023-2024.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ....b) ..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021)

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm/ identifikueshëm”<sup>4</sup>. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>5</sup>. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>6</sup>.

Pra, në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përjashtimit* ose *preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në

---

<sup>4</sup> Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.*

<sup>5</sup> Shih: *Molla kundër Greqisë, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; Fábían kundër Hungarisë, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1985, prg.72.*

<sup>6</sup> Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.*

trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkakun e gjendjes arsimore, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Referuar LMD, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “Diskriminimit i drejtëpërdrejtë”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “Diskriminimit të tërthortë” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të LMD, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në

mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Komisioneri vlerëson se, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese në radhë të parë duhet të provojë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtura.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në mënyrë të shprehur në lidhje me shkakun e gjendjes arsimore, të pretenduar nga ankuesja si arsyeja ose shkakun për të cilën ajo i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe të disfavorshëm, duke mos u përfshirë në listën e miratuar të udhëheqësve shkencorë për ciklin III, doktorantë në “Muzikologji” për vitin akademik 2023-2024.

LMD nuk jep një përkufizim se çfarë duhet të kuptohet me shkakun e gjendjes arsimore. Në praktikën e tij Komisioneri ka vlerësuar se, se diferencat në trajtim që bazohen në nivelin e arsimit të një personi<sup>7</sup> ose nivelin e arritjeve në arsim të një personi ose e thënë ndryshe në vlerësimet apo notat e përfituara gjatë ndjekjes së arsimit<sup>8</sup>, do të konsiderohen si diferencë në trajtim që bazohet në gjendjen arsimore. Komisioneri vlerëson se, *gjendja arsimore si shkak diskriminimi*, nënkupton diferencën në trajtim dhe trajtimin më pak të favorshëm që një person i nënshtrohet për shkak të nivelit individual të arsimit, arritjeve të tij në arsim, çertifikatave ose diplomave që një person posedon.

Duke iu rikthyer fakteve, rrethanave dhe pretendimeve për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore të paraqitur nga ankuesja Komisioneri Konstaton se:

Në nenin 79, të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohen kriteret që duhet të përmbushë drejtuesi shkencor i doktorantëve. Në pikën 6, të nenit 79, të këtij ligji përcaktohet: “6. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë. Ky numër përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë “Profesor” ndjek në të gjitha

<sup>7</sup> Shiko: Vendimin nr. 147, datë 26.10.2020, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

<sup>8</sup> Shiko: Vendimin nr. 48, datë 19.05.2020, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

*institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar dhe përcaktohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë..... ”*

Referuar listës së miratuar nga Departamenti i KMDP, rezulton se udhëheqësit shkencorë që janë përzgjedhur janë personel që mbajnë titullin “Akademik”, “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”, në përputhje me kërkesat ligjore të vendosura nga neni 79, i ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me udhëheqësit shkencor për kandidatët për Doktorantë. Pra, rezulton se, ankuesja e cila zotëron titullin akademik “Profesore e Asociuar” ka një titull akademik në të njëjtin nivel ose të një niveli më poshtë (krahasuar me titullin akademik “Profesor”), sikurse personeli akademik i miratuar si udhëheqës shkencor. Në këtë kuptim, nuk rezulton që diferenca në trajtim dhe trajtimin më pak i favorshëm, i pretenduar nga ankuesja, për shkak të mospërfshirjes në listën e udhëheqësve shkencorë për ciklin e III, Doktoratë në “Muzikologji” për vitin akademik 2023-2024 të ketë lidhje me gjendjen e saj arsimore që në rastin konkret i referohet titullit akademik që ajo gëzon.

Sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri arrin në përfundimin se, pavarësisht se, shkak i gjendjes arsimore, i pretenduar nga ankuesja si shkak i mbrojtur apo shkak diskriminues, përbën një shkak të mbrojtur nga LMD, faktet dhe rrethanat e parashtruara nga ankuesja, nuk ngrenë pretendime për diferencë në trajtim që kanë në bazë gjendjen arsimore të ankueses, duke iu referuar nivelit të titullit akademik që zotëron “Profesore e Asociuar”. Gjendja arsimore e ankueses, referuar këtu, titullit akademik “Profesore e Asociuar” nuk rezulton që të jetë arsyeja apo shkak i përjashtimit, që ankuesja pretendon se i ka ndodhur për shkak të mospërfshirjes në listën e udhëheqësve shkencorë për ciklin e III, Doktoratë në “Muzikologji” për vitin akademik 2023-2024, në Fakultetin e Muzikës, Universiteti i Arteve.

Në këto kushte, kur pretendimet e ankueses nuk ngrenë çështje të diferencës në trajtim apo të trajtimit më pak të favorshëm që kanë si shkak gjendjen arsimore, Komisioneri vlerëson se, nuk hyn në kompetencën e këtij institucioni, shqyrtimi i pretendimeve që ankuesja ka paraqitur në ankesën objekt shqyrtimi, për sa kohë që ato nuk mund të konsiderohen pretendime për diskriminim, sipas parashikimeve të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga znj.I.K, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk plotëson kriteret e kërkuara ligjore për t’iu nënshtruar procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës Nr. 215 regj., datë 16.10.2023, të paraqitur nga znj.I.K, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Gjendja arsimore  
Fusha: Punësim  
Lloji i vendimit : Mospranim